**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**
**TIRANË**

**Nr.11 Regj.Them.** **Nr. 10 VENDIMI**
**Datë Rregjistrimi 24.05.2021** **Datë 01.06.2021**

# V E N D I M

## "NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtare**: **Esmeralda XHILI** (*Relatore*)
**Gjyqtare**: **Emona MUÇI** (*Anëtare*)
**Gjyqtar:** **Asim VOKSHI** (*Anëtar*)
**Gjyqtare:** **Manjola XHAXHO** (*Anëtare*)
**Gjyqtare**: **Alma KOLGJOKA** (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 01.06.2021, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.11 Akti, datë 24.05.2021 dhe çështjen me nr.13 Akti, datë 26.05.2021 që i përket:

**PADIA E PARË:**

**PADITËSE:** ***Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI),*** përfaqësuar me Autorizimin nr. 337, datë 03.04.2021, nga Av. Altin Kaziaj.

**I PADITUR:** ***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*****,** përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.5604 Prot., datë 01.06.2021 nga Z. Olsi Peto.

**OBJEKTI:** Ndryshimi i vendimit nr.87, date 20.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanskioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

**BAZA LIGJORE:** Neni 145 e në vijim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.

**PADIA E DYTË:**

**PADITËSE:** ***Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN),***përfaqësuar me Autorizimin, nga Ivi Kaso dhe Marash Logu.

**I PADITUR:** ***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,*** përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.5604 Prot., datë 01.06.2021 Z. Olsi Peto.

**PALË TË INTERESUAR:** ***Partia Lëvizja Socialiste për Integrim,*** përfaqësuar me Autorizimin nr. 337, datë 03.04.2021, nga Av. Altin Kaziaj. ***Partia Socialiste e Shqipërisë,*** përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.180 Prot., datë 27.05.2021 nga Maringlen Legisi.

**OBJEKTI:**

1. Kundërshtimi i vendimit nr.87, date 20.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanskioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 36, të subjektit zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN).
2. Shpalljen e pavlefshmërisë të zgjedhjeve, për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Vlorë.
3. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Vlorë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 1, 18, 35, 42, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë. Nenet 6, 8 dhe neni 3, Protokolli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore. Nenet 136, 137, 145, 152, 153 156, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor. Nenet 14, 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile. Nenet 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Nenet 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të KQZ-së.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palëve, ku:

***Pala paditëse,***Partia Lëvizja Socialiste për Integrim,kërkoi:

- Pranimin e padisë së parë sipas objektit.

***Pala paditëse*,**Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN),kërkoi:

- Pranimin e padisë së dytë sipas objektit.

***Personi i Interesuar*,**Partia Socialiste e Shqipërisë, kërkoi:

- Rrëzimin e plotë të dy padive të ngritur nga subjektet zgjedhore Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), si të pabazuar në ligj dhe në prova.

***Pala e paditur*,**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkoi:

- Rrëzimin e dy padive të ngritur nga subjektet zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Kualicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 87, date 20.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanskioneve (KAS).

## V Ë R E N :

### I. *Procedura:*

1. Se pala paditëse në padinë e parë, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 24.05.2021, duke kërkuar "*Ndryshimi i vendimit nr.87, date 20.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.".*
2. Se pala paditëse në padinë e dytë, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 26.05.2021, duke kërkuar "*Kundërshtimi i vendimit nr.87, date 20.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 36, të subjektit zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN). Shpalljen e pavlefshmërisë të zgjedhjeve, për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Vlorë. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Vlorë.*
3. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor (Gjyqtari relator, në bazë të praktikës së ndjekur nga Kolegji) në datë 26.05.2021, në zbatim të neneve 57, 158/a(ë) të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 154 e 155 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë ka vendosur: "*Bashkimin e çështjes së paraqitur më pas me nr.13 akti, me datë regjistrimi 26.05.2021 me paditës Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), me çështjen zgjedhore të regjistruar më parë e cila mban nr.11 akti, datë regjistrimi 24.05.2021, me paditës Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)".* Me bashkimin e padive në njëçështje, u procedua me shqyrtimin e tyre në seancën e datës 01.06.2021.

### II. *Faktet e çështjes:*

4. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, caktoi datën 25 Prill 2021, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.
5. Në datën 25.04.2021, në 12 Zonat Zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Zona Zgjedhore Qarku Vlorë ka 10 (dhjetë) zona të administrimit zgjedhor, përkatësisht ZAZ nr.83, ZAZ nr. 84, ZAZ nr. 85, ZAZ nr. 86, ZAZ nr.87, ZAZ nr. 88, ZAZ nr. 89, ZAZ nr. 90, ZAZ nr. 91, ZAZ nr. 92.

6. Në datë 04.05.2021, me vendimin nr. 345, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Vlorë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
7. Sipas tabelës përmbledhëserezulton se subjekti zgjedhor Partia Socialiste për Integrim ka siguruar 6202 fletë të vlefshme votimi, të ndara sipas zonave zgjedhore si vijon:

-ZAZ nr.83, fletë votimi të vlefshme 615;
- ZAZ nr. 84, fletë votimi të vlefshme 773;
- ZAZ nr. 85, fletë votimi të vlefshme 752;
- ZAZ nr. 86, fletë votimi të vlefshme 767;
- ZAZ nr.87, fletë votimi të vlefshme 481;
- ZAZ nr. 88, fletë votimi të vlefshme 341;
- ZAZ nr. 89, fletë votimi të vlefshme 577
-ZAZ nr. 90, fletë votimi të vlefshme 1480;
- ZAZ nr. 91, fletë votimi të vlefshme 183;
- ZAZ nr. 92, fletë votimi të vlefshme 233;

8. Sipas tabelës përmbledhëserezulton se subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) ka siguruar 32128 fletë të vlefshme votimi, të ndara sipas zonave zgjedhore si vijon:

- ZAZ nr.83, fletë votimi të vlefshme 4101;
- ZAZ nr. 84, fletë votimi të vlefshme 4329;
- ZAZ nr. 85, fletë votimi të vlefshme 4590;
- ZAZ nr. 86, fletë votimi të vlefshme 4631;
- ZAZ nr.87, fletë votimi të vlefshme 3093;
- ZAZ nr. 88, fletë votimi të vlefshme 1854;
- ZAZ nr. 89, fletë votimi të vlefshme 1694;
-ZAZ nr. 90, fletë votimi të vlefshme 5060;
- ZAZ nr. 91, fletë votimi të vlefshme 1422;
- ZAZ nr. 92, fletë votimi të vlefshme 1354;

9. Kundër vendimit nr. 345, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) ka paraqitur ankim subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) duke pretenduar se:

   a) *Me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 219, datë 19.04.2021, për vendosjen në karantinë dy javore të shtetasve shqiptarë që vijnë nga Greqia apo Maqedonia e Veriut, në thelb është mohuar e drejta kushtetuese e zgjedhësve shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut për të ushtruar të drejtën e tyre të zgjedhin lirisht për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Vendosja e masave të tilla pak ditë para ditës së votimit dhe heqja e masave pak ditë pas mbarimit të procesit të votimit dëshmon për një vullnet të orientuar politikisht duke penguar shtetasit shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut të ushtrojnë të drejtën kushtetuese të votës. Ky urdhër ka ndikuar drejtpërdrejtë në pjesëmarrjen dhe rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Vlorë.*
   b) *Vetëm mbi bazën e njoftimit publik, autoritetet policore, në datën 20 prill 2021 e në vijim, në pikën kufitare me Greqinë, kërkonin prej qytetarëve plotësimin e formularëve për*

*vetëkarantinim, ndërkohë që në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, ende nuk ishte botuar një akt i autoritetit kompetent, me fuqi juridike, përkundrejt pasojave të tij rregulluese/urdhëruese. Ende pa u botuar akti në Fletoren Zyrtare, shtetasve shqiptarë në kufi, që hynin në territorin e Republikës së Shqipërisë, u kërkohej nënshkrimi i një formulari me detyrim, për vetëkarantinimin 14 ditor.*

c) *Pjesëmarrja më e lartë e zgjedhësve (përfshirë zgjedhësit shqiptarë me banim në Greqi) e konstatuar në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin apo Zgjedhjet Vendore, kanë qenë determinante në rezultatin zgjedhor të Subjektit "Lëvizja Socialiste Për Integrim". Më konkretisht Subjekti "Lëvizja Socialiste Për Integrim" ka arritur të sigurojë një mandat deputeti në zgjedhjete vitit 2013 dhe në zgjedhjet e vitit 2017, ndërkohë që në zgjedhjet e vitit 2021, nuk ka arritur të sigurojë një mandat deputeti pikërisht nga vendimet e sipërcituara antikushtetuese.*

10. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), e cila pretendon se:

a) *Gjatë periudhës mars-prill 2021, PD ka depozituar 50 kallëzime penale në Prokurorinë e Posaçme SPAK dhe 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve, të cilat kanë të bëjnë me vepra penale të tilla si "Shpërdorim detyre", "Korrupsion aktiv në zgjedhje", "Përdorim i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore" etj.*

b) *Në qarkun e Vlorës janë konstatuar raste të blerjes së votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera nga disa figura të larta të Partisë Socialiste, duke shpërndarë dhurata për kategori njerëzish me qëllime elektorale, duke dhënë kredi me kushte lehtësuese nga Buxheti i Bashkisë Vlorë, duke caktuar dhënien e një shpërblimi fundviti për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, duke ndryshuar strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësit e tjerë me arsim të lartë etj.*

c) *Janë përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve.*

d) *Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra.*

e) *Bashkia Vlorë është angazhuar përgjatë gjithë fushatës zgjedhore të vendosë infrastrukturën e këtij institucioni publik në shërbim të fushatës së Partisë Socialiste, si në rastin e një ekrani LED të vendosur në zonën e Lungo Mare, me lejen e Bashkisë Vlorë, i cili transmetonte 24 orë në ditë video propagandistike për arritjet e qeverisë.*

f) *Nga viti 2017 e në vijim, Qeveria ka nxjerrë 28 vendime duke shtuar numrin e punësimeve në strukturat e qeverisjes qendrore me 16645 pozicione të reja, për përfitim politik, duke devijuar vullnetin.*

g) *Sipas Ministrisë së Financave, për periudhën janar-prill 2021 janë paguar 20 milionë euro më shumë për paga krahasuar me në njëjtën periudhë të vitit 2020.*

h) *Me qëllim ndikimi në shtresat vulnerabël, bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, qeveria ka paguar për ndihmën ekonomike për familjet në nevojë 313,763,706 lekë më shumë për periudhën janar-prill 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020;*

i) *Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste si z. Alket Hyseni, z. Vullnet Sinaj etj, kanë shpërndarë leje legalizimi në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe Vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së;*

*j)* *Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021; këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata;*

*k)* *Në 17 prill 2021, Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi elektoral në qytetin e Durrësit, falenderoi patronazhistët për punën e bërë. Fakti që vetë Kryeministri e pranoi këtë fenomen dhe e normalizoi atë përmes falenderimeve, tregon se databaza të njëjta me ato të publikuara kanë ekzistuar në të gjithë Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe Vlorën. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR;*

*l)* *Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht mbi 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuese;*

*m)* *Zgjedhësit që ishin infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke çuar de facto në mohimin e të drejtës së tyre për të votuar. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar në ditën e zgjedhjeve ishte 23.00, ndërkohë që vetëm në qytetin e Vlorës ky numër ishte 304 individë. Kjo praktikë bie ndesh me dispozitat për të drejtat e votimit dhe barazinë e votës të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe në paragrafin 7.2 të Dokumentit të Kopenhagenit;*

*n)* *Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në, u evidentuan si problematikë edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR. Në opinionin e tyre të përbashkët, Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës dhe ODIHRi shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të nxituara dhe që nuk ishin paraprirë nga një proces i duhur konsultimi.*

*o)* *Numri i votave të pavlefshme ishte 83.026, ose 5% e numrit total të votuesve dhe ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve;*

*p)* *Ligji diskriminon kandidatët gjatë procesit zgjedhor, duke u lejuar vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidati tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta;*

11. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr.87, datë 20.05.2021 ka vendosur:

*"1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 36, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD - AN).*
*2. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 49, datë 10.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.*

*3. Lënien në fuqi të vendimit nr. Nr. 345, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".*
*4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve."*

12. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar:
Në lidhje me kërkimin e ankuesve për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë qark, është argumentuar:

a) *Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen "shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor". Shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu, shitblerja e votës që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh dhe që këtë herë u cilësua si "problem i përhapur", nuk u vëzhgua prej tyre në masë kritike....*
b) *Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjeti ligjor është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik që vërteton se shkelja e pretenduar është "shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor", sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor.*
c) Pasi ka analizuar dhe interpretuar nenin 160 të Kodit Zgjedhor, ndër të tjera, KAS ka parashtruar se:*Nga pohimet e avokatit të subjektit ankues PD rezulton se provat e paraqitura prej këtij subjekti ankues dhe të pranuara për shqyrtim nga KAS-i nuk faktojnë sa raste shitblerje vote, sa raste lejesh legalizimi, sa raste punësimi, sa raste mohimi të të drejtës për votim për emigrantët, sa raste votimi të shumfishtë ka pasur në qarkun e Vlorë. Po kështu, ato nuk faktojnë se sa secili prej këtyre fenomeneve, apo edhe i formave të tjera të përdorimit të burimeve shtetërore, i dhënies së ndihmave apo i ushtrimit të presionit mbi zgjedhësit kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e*

*votës. Sipas avokatit të subjektit kërkues këto të dhëna mund të reduktoheshin vetëm nga informacionet e institucioneve shtetërore. Pavarësisht nga ky fakt, subjekti ankues vetë nuk kishte bërë asnjë përpjekje për sigurimin e tyre, por kërkoi që KQZ-ja t'i merrte ato. Subjekti ankues nuk ishte në gjendje të identifikonte nëse ekzistonin dokumente pranë këtyre institucioneve që të përmbanin informacionin e kërkuar. Ai pohoi në seancë se nuk kishte disponuar mbi të dhëna nga informacionet e kërkuar në momentin e hartimit të kërkesës ankimore, por besonte se, nëse merreshin si prova, ato do të konfirmonin pretendimet e ankuesit.*

d) *Në rrethin e provave të pranuara për shqyrtim janë një grup dokumentesh fotokopje etj. KAS-i i pranoi këto prova për shqyrtim për shkak se ato ose janë marrë nga burime publike, ose nuk u kontestuan nga asnjëra nga palët e përfshira në proces.*

e) *Subjekti ankues ka depozituar si prova në mbështetje të pretendimeve të veta një kallëzim penal. Kallëzimi penal i depozituar si provë nuk provon në asnjë rast ekzistencën apo vërtetësinë e fakteve apo ngjarjeve të përshkruara në të. Ai provon vetëm faktin se PD për zonën zgjedhore Qarku Vlorë ka depozituar së paku një kallëzim penal.*

f) *Kodi Zgjedhor përcakton në pikën 4 të nenit 91: "katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore". Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1076, datë 24.12.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura", të ndryshuar" ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuara punonjësish publikë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1044, datë 18.12.2020 "Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar" është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit, prandaj nuk përbën shkelje, sikurse miratimi i vendimit nr. 1102, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021" nuk përbën shkelje, sepse ai është vendim procedurash dhe kriteresh lidhur me një fond që është dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021. Shkelja e kryer në favor të subjektit zgjedhor PS me nxjerrjen e VKM nr. 1076, datë 24.12.2020 formon kundërvajtje administrative sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Nga pohimet e përfaqësuesve administratës së KQZ-së rezulton se PD nuk ka bërë ankim në KQZ për këtë shkelje.*

g) *Në këtë kategori pretendimi bën pjesë edhe vendimi nr. 19, datë 25.02.2021 i Këshillit Bashkiak "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 109, datë 18.10.2018 për miratimin dhe zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga Buxheti I Bashkisë Vlorë".KAS konstaton se ky vendim përbën kundërvajtje administrative pasi ka sjellë lehtësim financiar për 185*

*përfitues. Por subjekti ankues nuk ka vënë në lëvizje KZHZ, sipas përcaktimeve të nenit 172 të Kodit Zgjedhor.*

h) *Lidhur me pretendimin e subjektit ankues PD-AN të shprehur në paragrafin nr. 33 të kërkesës së tyre ankimore, për shpalljen e tenderit në datën 6 janar 2021 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, KAS vëren se neni 3, pika 4 e vendimit nr. 9 , datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator i referohet ndalimit të 'dhënies së koncensionit'. Dhënia e koncensionit është procedura që kryhet në momentin që nënshkruhet kontrata midis koncesion dhënësit dhe koncensionarit. Shpallja e tenderit në vetvete nuk formon dhënie koncensioni, por është hapi i parë në fillimin e procedurave shumë mujore që përfundojnë me kontratën. Për këtë arsye, ky veprim nuk formon shkelje.*

i) *Një grup provash të depozituara nga subjekti ankues ilustrojnë debatin mediatik rreth të ashtuquajturit skandali i patronazhistëve, i cili ka lidhje me një bazë të dhënash prej rreth 900 mijë zgjedhësish, ku ishin fiksuar, ndër të tjera, dhe preferencat e aluduara politike të tyre. Nga tërësia e të dhënave të bazës janë me interes për zgjedhjet të dhënat për preferencat politike. Këto të dhëna janë dukshëm produkt i punës së "patronazhistëve", mbështetur në "eksplorimin" e tregut politik nga strukturat partiake. Kjo metodë eksplorimi politik bën pjesë në taktikat tradicionale të partive politike, ndonëse metodat ndryshojnë nga njëra parti në tjetrën. Pjesa tjetër e të dhënave janë të dhëna personale, që janë siguruar në mënyrë të paqartë, përveç listës me emra zgjedhësish e cila është publike dhe u ofrohet partive politike në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor (pika 2 e nenit 60). Përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale rregullohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Rrethanat e lidhura me skandalin e patronazhistëve provojnë shkallën e ulët të respektimit të rregullave të vendosura nga ky ligj në Shqipëri. Provat e paraqitura në këtë kontekst provojnë sensibilitetin ndaj ngjarjes, por jo ndikimin e saj tek votuesit. Subjekti ankues nuk solli prova se publikimi mund të kishte intimiduar zgjedhësit dhe t'i kishte mbajtur ata larg nga procesi i votimit. Pjesëmarrja në këto zgjedhje në zonën zgjedhore Qarku Vlorë ishte 106664 (33,50%), nga 110760 (35,96%) që ka qenë në vitin 2017 që ka qenë në vitin 2017. Në ditën e votimit misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it vuri re në disa qarqe "grupe të rinjsh që grumbulloheshin jashtë qendrave të votimit dhe dukej se kontrollonin zonën dhe mbanin shënim se kush votonte". Edhe kjo formë patronazhi është pjesë e taktikave elektorale të partive të mëdha, pjesë e metodave që kompletojnë bazat e të dhënave të partive politike. Por edhe për këtë nuk u servirën prova që të tregonin intimidimin e zgjedhësve apo detyrimin e tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar.*

j) *Kodi Zgjedhor ka parashikuar mundësinë për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit që të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin. Komisionit Rregullator i është lënë kompetenca e posaçme që të vendosë "zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin" (shkronja "ç" e pikës 2 të nenit 20). Në zgjedhjet e 25 prillit 2021 Komisioni Rregullator nuk e shfrytëzoi këtë kompetencë, duke mos e ligjëruar mundësinë e kësaj kategorie zgjedhësish të votonin në distancë. Në këto zgjedhje mund t'a shfrytëzonin këtë mundësi, nëse do bëhej e aplikueshme, vetëm 3613 zgjedhës nga 4572 shtetas të regjistruar me banim jashtë shtetit (të dhënat janë marrë nga KQZ-ja). Për shkak të mosaplikimit të votimit nga jashtë vendit, e drejta e tyre e votimit do të realizohej në këto zgjedhjeve vetëm nëpërmjet paraqitjes në qendrën e tyre të votimit. Ky modalitet votimi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Pamundësia e votimit në*

*distancë në këto zgjedhje për shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit nuk formon shkelje. Atje ku nuk ka shkelje nuk ka pavlefshmëri.*

k) *Subjektet ankuese ngritën pretendime kundrejt urdhrit nr.219, datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një "vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës". Urdhri i sipërcituar është motivuar me nevojën për të dominuar përhapjen e epidemisë COVID19, në kushtet e "kontakteve më intensive në popullatë deri në përfundim të festës dhe veprimtarive fetare të lidhura me pashkët ortodokse". Vetizolimi i personave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë është një masë që është marrë në mënyrë të përsëritur që nga koha e nisjes së pandemisë dhe ka qenë e lidhur me statistikat e sëmundshmërisë dhe pritshmëritë nga ngjarje të caktuara. Mbyllja, Izolimi apo vetizolimi kanë qenë masa dominuese edhe në rastet e festave të tjera zyrtare, publike ose fetare. Në kohën që u mor kjo masë Republika e Greqisë ka pasur në fuqi izolimin 14 ditor dhe numrin e kufizuar të hyrjeve për personat që hynin në territorin grek nga Shqipëria. Më vonë kjo masë u shndërrua në izolim 7 ditor. Shqipëria e mbajti në këmbë këtë masë deri më datën 3 maj 2021, d.m.th. deri pas festës. Urdhri nr.219, datë 19.04.2021 është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.*

l) *Subjektet ankuese PD – AN ka ka referuar se në Qarkun Vlorë në ditën e zgjedhjeve kanë qenë 304 persona të infektuar me COVID-19, sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë. Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës. Për zgjedhësit e kësaj kategorie nuk ka qenë e mundur të votonin në kushtet e izolimit. Deklarata e Misionit vëzhgues të OSBE-ODIHR-it e ka quajtur këtë "mohim de facto i të drejtës për të votuar" (faqe 7). Kodi Zgjedhor nuk parashikon mundësinë e votimit në distance për zgjedhësit me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, sikurse nuk autorizon KQZ-në që të përpunojë rregulla dhe të marrë masa për kryerjen e një votimi të tillë. Ky është kuadri ligjor për zgjedhjet. Kushtetueshmëria e tij nuk është sfiduar në rrugë ligjore. Edhe kushtetueshmëria e rregullave të izolimit për shkak të pandemisë COVID-19 nuk është sfiduar në rrugë ligjore. Kjo është arsyeja që Misioni vëzhgues e quan rezultatin mohim de facto, por nuk e quan shkelje. Atje ku nuk ka shkelje nuk ka pavlefshmëri.*

m) *Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Vlorë numri i këtyre votave është 4730 ose 4.43%e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë,sepse mungon baza krahasuese. Pas ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor, votuesve iu dha mundësia të ushtronin të drejtën e tyre, duke hedhur dy vota, një për subjektet dhe një tjetër për kandidatët. Statistika nuk mund të krahasohet me votimet e kryera në Shqipëri, kur zgjedhësit kanë hedhur vetëm një votë. Në vlerësimin e subjektit ankues pavlefshmëria e lartë lidhet me kompozimin e fletës së votimit, gjë që përforcohet edhe nga deklarata e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve e datës 28.04.2021. Subjekti ankues nuk paraqiti asnjë fakt që të provonte lidhjen shkakësore midis vendimit të*

*Kolegjit Zgjedhor për përmbajtjen e fletës së votimit dhe numrit të lartë të fletëve të pavlefshme. Deklarata e Komsionerit nuk e nxjerr këtë lidhje. Nga ana tjetër, ka një grup shkaqesh, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë analizës faktike rreth kësaj çështjeje si p.sh. fakti se në këto zgjedhje u votua me dy vota dhe propabiliteti i gabimit dyfishohej, fakti se fushata edukuese nuk pati efektin e dëshiruar ose nuk e davariti dot konfuzionin, fakti se kandidatët nuk harmonizuan dot mënyrën e re të votimit me taktikat elektorale, apo fakti se pavlefshmëria mund të ishte mënyrë votimi me dashje nuk mund të eliminohen vetëm për shkak se nuk përputhen me linjën e arsyetimit të ankuesit. Misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it identifikon si shkak të mundshëm vonesën në nisjen e fushatës informuese-edukuese Pavlefshmëria e votës është pjesë e rregullave të votimit dhe numërimit të votave, nuk është mohim i së drejtës për të votuar (nuk ka mohim të së drejtës kur e drejta është ushtruar), nuk është shkelje e Kodit Zgjedhor, për pasojë nuk formon shkak për pavlefshmëri të zgjedhjeve.*

n) *Subjekti ankues PD ka përfshirën në ankim një numër provash që bëjnë fjalë për individë të aluduar me rekorde të tmerrshme kriminale, të cilët janë të lidhur me interesa biznesi me shumicën qeverisëse dhe që janë përfshirë "si eksponentë që kontribuonin në këtë fushatë edhe për shkak të përfitimeve që kanë marrë nga PS". Faktet e referuara në provat e depozituara dhe në shtjellimin e kërkesës ankimore nuk krijojnë lidhje faktike dhe logjike me shkelje të Kodit Zgjedhor dhe nuk provojnë kërkesën për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve.*

o) *Subjekti ankues PD u tërhoq nga pretendimi i tij i shprehur në pikat 51 - 53 të kërkesës ankimore dhe e zëvendësoi atë me pretendimet që rezultuan nga administrimi i rezultateve të kryqëzimit të të dhënave nga pajisjet PEI të përdorura për identifikimin e votuesve. Subjektet ankuese në tërësi pretenduan se materiali shpjegues me statistikat e kontrollit të kryqëzuar të të dhënave PEI dhe dëshmia e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve provojnë se ka pasur parregullsi në administrimin e pajisjeve, të cilat kanë lidhje me regjistrimin e një gjurme daktiloskopike për më shumë se një identitet zgjedhësi, sikurse ka pasur raste të izoluara të personave me identitet dhe gjurmë daktiloskopike të njëjte në dy qendra votimi të ndryshme. Në vlerësimin e përfaqësuesit të subjektit ankues PD ky fakt provon se ekziston mundësia që një person i vetëm të ketë votuar në emër të shumë zgjedhësve dhe kjo e bën votimin në këto raste të pavlefshëm. Nga shqyrtimi i materialit të servirur nga KQZ-ja rezulton se ai jep informacion për fazën e parë të hetimit administrativ që neni 167/2 i KZ kërkon të kryhet "pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar, të jenë përmbyllur procedurat ankimore dhe zgjedhjet të kenë përfunduar" me qëllimin "për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave". Rezultatet e servirura në material formojnë indicie për hetimin administrativ të KQZ-së, por nuk formojnë dot prova për të mbështetur pretendimin e subjekteve ankuese" për raste të shumta të votimit të dyfishtë". Materiali i servirur konstaton se për zonën zgjedhore ka një listë prej 23 rastesh të identifikuara me gjurmë daktiloskopike të dyshuara të njëjta nga pajisjet, por jo të përputhshme. Nëse gjurmët do ishin të përputhshme, atëherë pajisja do t'i kish deklaruar të përputhshme ato. Vetëm në dy raste ky dyshim përqas gjurmën daktiloskopike me identitetin e njëjtë në dy qendra votimit të ndryshme. Mbi bazën e informacionit të përftuar nga materiali i servirur mund të ngrihen vetëm hipoteza për sjelljen e zgjedhësve të evidentuar por nuk mund të krijohet bindja për shkelje të provuara, aq më tepër për votim të dyfishtë. Nga palët në proces u argumentua*

*se materiali i servirur provon se administrimi i procesit nga operatorët ka qenë i parregullt. KAS-i çmon se ky pretendim nuk ka lidhje me pretendimin për votim të shumëfishtë për të cilin ishte kërkuar marrja e provës. Ky material dhe stadi aktual i hetimit administrativ të KQZ-së nuk e provon pretendimin për votim të shumëfishtë.*

p) *Subjekti ankues PD e ka mbështetur kërkesën e vet për pavlefshmëri edhe në deklaratën e Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për gjetjet dhe konkluzionet paraprake, të datës 26.04.2021. Dokumenti përmban gjetje dhe të dhëna për shitblerjen e votës dhe për përdorimin e burimeve shtetërore, të cilat janë referuar në kërkesën ankimore. Në vlerësimin e këtij dokumenti KAS-i duhet të ndajë referencat me burim interlokutorët nga referencat me burim vëzhguesit e misionit. Në vlerësimin e tij të përgjithshëm Misioni vëzhgues ka konstatuar se edhe në këto zgjedhje "mbetën problem praktikat gjerësisht të përhapura të blerjes së votës" (faqe 2), sikurse ka konsideruar të besueshme "raportimet sipas të cilave koordinatorët e partive të mëdha u ishin afruar për t'u blerë votat një numri domethënës votuesish nga komunitetet rome dhe egjiptiane (faqe 16). Deklarata evidenton faktin se "ministrat vijuan fushatën përgjatë veprimtarive zyrtare dhe me këtë publicitet i dhanë përparësi domethënëse partisë qeverisëse", sikurse thekson se ishin shqetësim dhënia e iniciativave dhe pretendimet për presion mbi nëpunësit publikë (faqe 2). Dokumenti nuk përmban të dhëna specifike në lidhje me Qarkun Vlorë në këto aspekte. Gjetjet dhe konkluzionet paraprake të deklaratës janë të besueshme dhe të pranueshme. Sipas gjetjeve dhe konkluzioneve të kësaj deklarate të ODIHR, ka përhapje të fenomenit, blerja e votave është e pranishme si metodë së paku tek partitë e mëdha. Gjithsesi, përmasat e këtyre fenomeneve nuk formojnë, në gjykimin e misionit vëzhgues, shkak për pavlefshmëri, përndryshe deklarata nuk do t'i konsideronte zgjedhjet si zgjedhje ku "votuesit mund të zgjidhnin midis kandidatësh, të cilët mund të bënin lirshëm fushatë, me një kuadër ligjor që respekton liritë themelore" dhe ku "zgjedhjet ishin në përgjithësi të mirorganizuara" (faqe 1).*

q) *Subjekti ankues PD kërkoi nga KAS-i që të merrte në cilësinë e provës 19 informacione specifike nga institucione të ndryshme që veprojnë në territor. KAS-i, pas shqyrtoi kërkesën vendosi me shumicë votash rrëzimin e saj për shkak se:*

r) *<u>subjekti ankues nuk ka bërë përpjekje për të siguruar paraprakisht provat</u>, sikurse kërkon shkronja "c" e pikës 1 të nenit 136 të Kodit Zgjedhor. Ky është një kusht ligjor që duhet të demonstrohet se është plotësuar në momentin që paraqitet kërkesa për marrjen e provës, përndryshe dispozita nuk do kërkonte që kërkuesi të paraqitëse njëkohësisht me kërkesën edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i provave;*

s) *<u>informacionet e kërkuara nuk gëzojnë cilësinë e provës</u>, sipas Kodit të Procedurës Civile dhe për këtë shkak nuk mund të kërkohen si të tilla. Kodi garanton të drejtën për të kërkuar prova, jo sende që nuk janë të tilla. Llojet e provave janë të përcaktuara. Asnjeri prej 19 kërkimeve nuk bën pjesë në asnjërin nga llojet e provave që përcakton KPrC;*

t) *<u>Kërkimi nga institucionet shtetërore i informacioneve që nuk ekzistojnë, por që duhet të prodhohen prej tyre del jashtë tagrave që i njeh KAS-it pika 1 dhe pika 2 e nenit 137 të Kodit Zgjedhor.</u> Kërkesat e subjektit ankues janë në fakt kërkesa për të vënë në punë institucionet, me qëllim që ato të hulumtojnë, studiojnë, analizojnë, apo prodhojnë statistikë lidhur me fenomenet e pretenduara si shkelje nga ana e subjektit ankues.*

u) *Subjekti ankues PD, i pyetur nga KAS-i, nuk referoi tek asnjë dokument zyrtar i këtyre institucioneve ku mund të gjendeshin informacionet e kërkuara, pavarësisht se është në detyrimin e tij të identifikojë provën dhe të tregojë se ku ndodhet ajo (neni 126, pika 1*

*shkronja "dh"), sikurse pranoi se nuk kishte dijeni nëse informacionet e kërkuara ekzistonin apo jo. Shumica e anëtarëve të KAS-it çmojnë se ushtrimi në këto kushte i privilegjit nga dy anëtarë për të kërkuar marrjen e provave në mbështetje të pikës 3 të nenit 136 të KZ përbën tejkalim të autorizimit ligjor dhe dëmton administrimin e rregullt dhe në afatet e përcaktuara ligjore të shqyrtimit administrativ. Kërkesa e dy anëtarëve të KAS-it drejtuar KQZ-së për marrjen e të dhënave të kryqëzuara ndërmjet pajisjeve të identifikimit elektronik PEI për të gjitha zonat e ankimuara gjithsesi ka vlerë sepse ilustron më së miri pse kërkimet mësipërme të subjektit ankues përtej kushteve dhe kufizimeve të neneve 136 dhe 137 mund të dëmtonin shqyrtimin administrativ. Për shkak se prova e kërkuar nga dy anëtarët nuk ekzistonte, KAS-i u detyrua të pezullonte shqyrtimin e çështjes për shumicën e kërkesave ankimore, për 1 -7 ditë, deri sa KQZ-ja të bënte kryqëzimin e të dhënave dhe të nxirrte një rezultat të administrueshëm nga palët dhe KAS-i.*

<u>Përfundimisht KAS ka vlerësuar se:</u>

*"1. Shqyrtimi administrativ evidentoi raste shkeljesh të detyrimeve ligjore, të cilat formojnë kundërvajtje administrative. Shkeljet e evidentuara nuk provohet të kenë pasur ndikim në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim, në ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të së drejtës së tyre apo në tjetërsimin e vullnetit. Ato nuk formojnë "shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor" dhe as "shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore", për pasojë nuk mund të shërbejnë si shkak për të shpallur zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi.*
*2. Çdo ngjarje, fakt apo situatë e zhvilluar në zbatim apo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nuk formon shkelje dhe nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.*
*3. Çdo shkelje e pretenduar dhe që nuk mund të provohet se ka ndodhur ose se ka pasur ndikim mbi zgjedhjet në formën e pengimit të zgjedhësve për të marrë pjesë në votim, detyrimit të tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar apo në formën e tjetërsimit të votës nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.".*

13. Subjekti politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) pasi janë informuar mbi vendimin e K.A.S. duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova i janë drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me paditë objekt gjykimi.

14. <u>*Pala paditëse, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI),*</u>në kërkesë padinë e parë dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, pretendoi se:
    a) Vendimi objekt ankimi nr. 87, datë 20.05.2021 është i pabazuar në ligj dhe në prova në lidhje me shqyrtimin dhe rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 49, datë 10.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor LSI.
    b) Në fazën finale të ankimit administrativ pranë KAS, paraqitur nga LSI, për Qarkun Vlorë, ky subjekt zgjedhor ka kundërshtuar vendimi Nr. 345, datë 04.05.2021 të KSHZ, në

lidhje me rezultatet e zgjedhjeve në Qarkun Vlorë, duke kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për këtë qark dhe rregullimin e pasojat përkatëse.

c) Përfundimisht, subjekti zgjedhor LSI, kërkon ndryshimin e vendimit të KQZ/KAS nr. 87, datë 20.05.2021, shpalljen e pavlefshmërisë ligjore të rezultateve të Qarkut Vlorë dhe urdhërimin e përsëritjeve të zgjedhjeve, pasi ajo disponon të gjitha provat, që mbështesin këtë kërkim.

d) Sipas LSI, me urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë me nr.219 datë 19.04.2021, në thelb është mohuar e drejta kushtetuese e zgjedhësve shqiptare me banim në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut për të ushtruar të drejtën e tyre për të zgjedhur lirisht në zgjedhjet e datës 25.04.2021. Kjo masë e propozuar dhe e marrëkatër ditë përpara datës së zgjedhjeve, provoi se vendimmarrja propozuese e Komitetit Teknik të Ekspertëve dhe akti miratues i Ministrisë së Shëndetësisë, ishin akte të formësuara nga një vullnet jo objektiv, por i orientuar politikisht dhe që solli si pasojë direkte negative pengimin e këtyre qytetarëve për ushtrimin e së drejtës së votës.Ky orientim politik u pa qartë me anullimin në datë 03.05.2021 të këtij urdhri, pikërisht pak ditë pas mbarimit të zgjedhjeve. Vendosja e masave të tilla pak ditë përpara datës së votimit dhe heqja e masave pak ditë pas procesit të votimit, dëshmon për një vullnet të orientuar politikisht duke penguar shtetasit shqiptarë me banim jashtë të ushtrojnë të drejtën kushtetuese të votës.

e) Ende pa u botuar akti në Fletore Zyrtare, shtetasve shqiptarë në kufi që hynin në territorin e R.Sh. u kërkohej nënshkrimi i një formulari me detyrim për vetëkarantinim 14 ditor. Kjo kërkesë ka ardhur mbi bazën e një akti që nuk kishte hyrë akoma në fuqi. Një akt i tillë në situatën konkrete, jo vetëm që ka penguar emigrantët shqiptarë që të hynin në Shqipëri, por nga mënyra sesi ka nisur implementimi i tij, përmes detyrimit për të nënshkruar një formular dhe për t`u vetëkarantinuar, pa marrë në konsideratë as rastet kur nëse shtetasit paraqesin testin e kryer PCR ose çdo test tjetër laboratorik, ka cënuar rëndë garancitë kushtetuese të këtyre shtetasve për të hyrë në Shqipëri për të votuar.

f) Disa shoqata emigrantësh, përfaqësues të shoqërisë civile bën apel për heqjen e këtyre masave. Edhe Presidenti i RSH ka kërkuar marrjen e masave urgjente, gjithashtu Avokati i Popullit ka paraqitur rekomandimin për anulimin tërësisht të urdhrit nr.219/2021.

g) Vendimmarrja e KAS lidhur me ankimimin për qarkun Vlorëështë e pambështetur dhe për pasojë duhet të prishet nga Kolegji Zgjedhor, duke disponuar për pranimin e padisë, sipas objektit të padisë.

h) Analiza e fakteve dhe provave të depozituara pranë KAS, në cilësinë e provave materiale është bërëjo vetëm në përputhje me parimet e përgjithshme të vlerësimit të provave, në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor, K.Pr.Civile, K.Pr.Administrative. Vullneti i pakët dhe dashakeqas i tre prej anëtarëve të KAS është frut i urdhrave politikë të subjektit politikë, nga i cili këta anëtarë janë propozuar. Ky vendim është bazuar vetëm mbi urdhra politikë duke shpërdoruar dhe shkelur dispozitat eksplicite ligjore të cilat normojnë paligjshmërinë në procesin elektoral.

15. *<u>Pala paditëse, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN)</u>*,në kërkesë padinë e dytë dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se:

a) Vendimi i KAS është i cënueshëm, ai është marrë në shkelje të ligjit procedural dhe ligjit material, si dhe nuk është kryer një hetim i plotë e i gjithanshëm.

b) <u>Në lidhje me ligjin procedurial</u>: Subjekti zgjedhor PD – AN gjatë hetimit administrativ ka vendosur në dispozicion të KAS çdo provë të siguruar nga vetë ajo, më qëllim identifikimin e të gjitha aspekteve të paligjshmërisë që karakterizuan procesin zgjedhor të 25 prillit.
c) Në kushtet kur një pjesë e provave ka qënë e pamundur të sigurohet nga subjekti, ky i fundit i ka kërkuar KAS-ti që t`i drejtohet organeve të administratës shtetërore, për të vënë në dispozicion informacione, dokumente dhe çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.
d) Kërkesa e subjektit është refuzuar nga KAS, kjo në shkelje flagrante të nenit 136, pika 1, gërma "c" dhe nenit 137 të Kodit Zgjedhor.
e) <u>Në lidhje me themelin e pretendimeve për pavlefshmëri:</u>
f) <u>Në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve</u>: Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë, sipas përcaktimeve të nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Ndërsa në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja, eventualisht Kolegji Zgjedhor urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.
g) Në rastin konkret, subjekti zgjedhor PD-AN ka parashtruar një numër të madh shkeljesh të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore dhe Kodit Zgjedhor, të cilat në tërësinë e tyre cënojnë rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Tërësia e këtyre shkeljeve krijon bindjen e plotë bazuar në fakte dhe prova të pakundërshtueshme, si dhe Kodin Zgjedhor, për shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Vlorë.
h) <u>Mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve</u>: Deri në datën 19 prill 2021, nuk ka pasur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hynin në Shqipëri dhe të vendoseshin në karantinë. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi, për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuese.
i) Zgjedhësit, që ishin të infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke u cënuar de facto e drejta e tyre për të votuar.
j) E drejta e çdo qytetari shqiptar për të votuar është e sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht është një nga të drejtat themelore e parashikuar në nenin 3, Protokolli 1 të KEDNj.
k) Ndërsa në neni 24 dhe 25 të Kodit Zgjedhor, është parashikuar shprehimisht e drejtën e votimit për emigrantët shqiptar në vendin e tyre të rezidencës, mundësi kjo e cila nuk u është dhënë, duke mohuar një nga të drejtat e tyre themelore.
l) <u>Blerja e votës dhe përdorimi i personave me rekorde të tmerrshme kriminale:</u>Në qarkun Vlorë është konstatuar shitblerja e votave dhe shkeljet e tjera flagrante. Ndërtimi i një skeme kriminale, e shtrirë në të gjithë Qarkun e Vlorë për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde kriminale, përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor, e për rrjedhojë duke ndikuar

drejtpëdrejtë në ndarjen e mandateve. Ky ndikim është veçanërisht domethënës për Qarkun e Vlorës ku diferenca ndërmjet PD LSI dhe PS është vetëm 1176 vota.

m) Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të OSBE/ODIHR. Faktohet në këtë raport se deri në datën 24 prill 2021, janë hapur më shumë se 30 çështje pranë strukturave të SPAK.

n) <u>Blerja e votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera:</u>Shitblerja e votës u krye nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera të cilat përbënin problem në procesin zgjedhor duke devijuar vullnetin e qytetarëve. Qeveria nëpërmjet akteve nënligjore ka miratuar Vendime Qeverie nëpërmjet të cilave është mundësuar dhënien e një shpërblimi në fundvit, për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit. Është vendosur të ndryshohet struktura dhe niveli i pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe punonjësit e stafit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, Njësisë Mjekësore Ushtarake në Spitalin Universitar të Traumës, në strukturat e Forcave të Armatosura dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Gjithashtu është vendosur akordimi i kredive të buta, me Vendim të Këshillit Bashkiak Vlorë, dhënia e ndihmave financiare, kategorisë në nevojë etj.

o) <u>Investimet publike:</u> Shteti ka vendosur investimet publike në funksion të PS-së për zgjedhjet e 25 Prill 2021. Neni 3 i Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisonit Rregullator të KQZ-së, ndalon mbështetjen dhe promovimin, në periudhën 4-mujore para datës së zgjedhjeve, të projekteve ose investimeve, me interes apo shtrirje territorial kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interesit të publikut. Megjithatë në të paktën 20 raste në të gjithë vendin, 1 prej të cilave në Qarkun e Vlorës, kryeministri, ministrat dhe deputetët promovuan projekte apo investime publike me qëllime të qarta elektorale. Ndërkaq rasti më flagrant i kësaj shkelje është dhënia me Koncesion/PPP nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, projektimi, ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe transferimi i portit turistik në qytetin e Vlorës (Marina Vlorë) me një kohëzgjatje 35 vjeçare. Një fakt i tillë është evidentuar dhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.

p) <u>Intimidimi i administratës shtetërore për të mbështetur PS:</u> Gjatë fushatës u konstatuan raste të shumta të cilat janë denoncuar vazhdimisht nga PD, sesi të gjitha nivelet e administratës vendore dhe qendrore ishin përfshirë në fushatë duke mbështetur publikisht kandidatët e PS-së. Veç kësaj punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore. Sipas INSTAT në 2020 punësimi në sektorin publik u rrit me 6% pra me 10.572 persona. Ndërkohë, më 24 Dhjetor, qeveria autorizoi edhe krijimin e 2.472 pozicione të reja në administratën publike. Qartësisht, punësimet në administratën publike në periudhën zgjedhore, kur nuk diktohen nga nevoja të ngutshme, kanë për qëllim të përkthehen në mbështetje dhe vota për partinë në pushtet. Subjekti Zgjedhor PD –AN në argumentat e saj i është referuar dhe statistikave të publikuar nga Ministria e Financës.

q) Këto veprime janë shkelje të rënda ligjore, të cilat kanë si qëllim përfitim politik duke devijuar vullnetin e votuesve. Konstatimet e sipërcituara janë evidentuar edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.

r) <u>Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore</u>: Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste kanë shpërndarë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit

Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Kjo kategori, nuk e ka në kompetencë të shpërndajnë një dokument të tillë nga zyra e ASHK-së. Këto veprime qartazi tregojnë se si Partia Socialiste e ka vendosur shtetin në dispozicion të qëllimeve të saj elektorale. Në raste të përsëritura, për të cilat Partia Demokratike disponon foto dhe video, ku kandidatë për deputetë shpërndanë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor, me qëllim të pastër elektoral. Në 20 Prill, u publikua një audiopërgjim i drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës, gjatë një takimi me vartësit e tij, ky i fundit u *kërkon "...që mos procedojnë më tej me rreth 100.000 kërkesa për leje legalizimi të banesave private, të cilat me siguri do të refuzohen duke sjellë prishjen e tyre...."*

s) Sa më lart, paditësi PD –AN, konkludon se, është e qartë se parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u cënua rëndë pasi Shteti dhe Partia në pushtet (PS) u shkrinë në një. Një konstatim i tillë gjendet dhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR). Ky përdorim masiv i burimeve shtetërore, përveçse një veprimtari e paligjshme, e cila duhet hetuar dhe dënuar nga organet e drejtësisë, është në shkelje flagrante të neneve 78, 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe neneve 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, çka ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në vullnetin e zgjedhësve, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Vlorë.

t) <u>Përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale:</u> Shteti vendosi të dhënat personale në dispozicion të serverave të PS në Tiranë dhe Vlorë. Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021; këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata.Rrjedhja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabil. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.

u) Mbledhja, përpunimi, përdorimi dhe publikimi i të dhënave personale pa pasur miratimin me shkrim të mbajtësit të të dhënave është shkelje e rëndë e nenit 35 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 8 të Konventës Evropiane dhe neneve 6 dhe 7 të ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

v) Duke qenë se Shteti dhe Partia ishin të pajisur me informacion për secilin zgjedhës, përfshirë edhe bindjet e tyre politike, kjo i bëri më vulnerabël përballë pushtetit dhe më lehtësisht viktimë e presioneve apo mjeteve të tjera të kundërligjshme për të ndaluar të shprehin vullnetin e tyre lirisht, duke përdorur mekanizma të ndryshëm pengues.

w) <u>Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor:</u> Në datën 30.07.2020, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit 115/2020, miratoi nismën e PS-së për disa ndryshime kushtetuese. Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në u evidentuan si problematika edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR.

x) <u>Numri i madh i fletëve të votimit të pavlefshme</u>:Numri i votave të pavlefshme ishte 83.026, ose 5% e numrit total të votuesve dhe vetëm për Qarkun e Vlorës ishin 4730 vota

të pavlefshme, ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve.

y) Miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lart të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përkthyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet palëve është e ngushtë, por edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka vetëm katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë.

z) Diskriminimi i kandidatëve gjatë procesit zgjedhor: Ligji u lejon vetëm Kryetarëve të partive, por asnjë kandidati tjetër që të kandidojë deri në 4 zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta, ky fakt, përbën një diskriminim në të drejtën për t'u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës.

aa) Votimi më shumë se një herë: Një nga risitë e zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 ishte identifikimi elektronik i zgjedhësve. Futja e këtij mekanizmi të ri në Kodin Zgjedhor ishte kërkuar me forcë nga PD dhe kishte qenë pjesë e konsensusit të arritur ndërmjet palëve për ndryshimet e Kodit Zgjedhor në Korrik 2020. Nëpërmjet identifikimit elektronik synohej të eliminohej votimi më shumë se një herë, në të njëjtën qendër votimi apo qendra të tjera, votimi për të tretët apo votimi familjar. Por, gjithsesi ajo që mbetet problematike është fakti se nga informacionet e marra në terren nga strukturat e Partisë Demokratike rezultoi se këto fenomene nuk janë shmangur. Nga subjekti zgjedhor PD –AN jepen detaje mbi rastet konkrete.

bb) Si përfundim, subjekti zgjedhor PD – AN, vlerëson se, në tërësinë e tyre këto shkelje të ligjit shqiptar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, është e qartë se vendimet e marra në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar një rezultat në shpërputhje me vullnetin e zgjedhësve, e për rrjedhojë edhe ndarjen e mandateve, dhe për rrjedhojë në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ky proces zgjedhor në Qarkun Vlorë duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në këtë qark.

cc) Në tërësinë e tyre këto shkelje flagrante të ligjit – shitblerja e votës, përdorimi i personave me precedentë kriminalë, përdorimi i paligjshëm i administratës, vjedhja dhe përdorimi kriminal i të dhënave personale të shtetasve nga PS, përdorimi i paligjshëm, masiv dhe sistematik i parave të buxhetit të shtetit për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve dhe përdorimi i lejeve të legalizimit për vota – cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Qarku Vlorë. Këto shkelje dhe pasojat e tyre përmbushin kriteret e kërkuara nga nenet 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Vlorë.

dd) Me qëllim garantimin e të drejtës së palës ankuese për një proces të rregullt ligjor, PD-AN parashtron kërkesat e saj për marrjen e provave pranë organeve të administratës publike, në përputhje me nenet 136 dhe 137 të Kodit Zgjedhor, dhe nenet 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile.

ee) Bazuar në nenin 42 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore dhe nenet 158, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, përfundimisht, kërkohet: *"Pranimin e padisë për shfuqizimin e vendimit nr. 87, darë 20.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS). Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Vlorë dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Vlorë".*

16. *Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, gjatë gjykimit pretendoi se: Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, gjatë gjykimit pretendoi se, vendimi nr. Nr. 87, datë 20.05.2021 i KAS, është i bazuara në ligj dhe në prova dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

17. *Personi i Interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë, gjatë gjykimit*, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, pretendoi se:
    *a)* Paditë e ngritura kundër vendimit të KAS Nr. 87, datë 20.05.2021 janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe duhet të rrëzohen nga Kolegji. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vlerësuar drejt dhe saktë të gjitha pretendimet duke interpretuar me përpikmëri ligjin zgjedhor për mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre.
    *b)* *Për sa i përket pretendimeve të subjektit politik Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim:*
    *c)* Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit. Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen "shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor". Shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur.
    *d)* Në interpretim të nenit 125/4 dhe 160 të Kodit Zgjedhor, në çdo rast kërkesa për pavlefshmëri duhet të përmbajë të nominuar qendrën apo qendrat e votimit për të cilat kërkohet pavlefshmëria e rezultatit zgjedhor të miratuar. Secila qendër votimi ka specifikat e veta apo shkaqe të ndryshme, të veçanta ose të përbashkëta për konstatimin e elementëve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe kjo gjithmonë në varësi të bazës faktike të pretendimit të parashtruar nga paditësat.
    *e)* Nga ana e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë janë pretenduar fakte që lidhen me shitblerjen e votës, mohim të se drejtës për të votuar, raste të votimit të shumëfishtë, raste punësimi, dhënie ndihmash etj, por asnjëherë të provuara se sa kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës. Në asnjë moment nuk pretendohet pavlefshmëri në një apo disa qendra votimi konkrete të qarkut të Vlorës.
    *f)* Po ashtu ky subjekt ka pretenduar shkelje të ligjit zgjedhor që lidhen me ushtrimin e veprimtarive të ndaluara si miratimi i V.K.M apo ndryshimeve të V.K.M, por që nuk janë ankimuar asnjëherë prej tij në KQZ.

g) *Për sa i përket pretendimeve të Subjektit Politik Lëvizja Socialiste për Integrim:*

h) Paditësi L.S.I kundrejt urdhrit nr. 219, datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një "vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës". Ky urdhër është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë dhe në gjykatën administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.

i) Lidhur me pretendimin tjetër se në ditën e zgjedhjeve, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 ishte rreth 23.000 Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre janë qytetarë të qarkut të Vlorë, e as faktin se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës.

j) Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Vlorë numri i këtyre votave është 4730 ose 4.83% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese, fakt ky i konstatuar drejt nga KAS.

k) Në tërësinë e tyre, të gjitha faktet apo ngjarjet e pretenduar prej paditësave përveçse janë të paprovueshme për kundërligjshmërinë e tyre, nuk referojnë në të paktën një qendër votimi qarkun e Vlorës dhe nuk parashtrohet asnjë arsyetim i detajuar sipas kërkave të ligjit. Ky është tregues i padiskutueshëm se shkaqet e pretenduara nuk janë gjë tjetër vecse parashtrime formale pa asnjë thelb të njohur nga ligji zgjedhor.

l) Edhe sikur të kishte patur shkelje ligji, këto shkelje duhet që të kenë ndodhur në qendrën e votimit dhe jo në vende të tjera, si edhe të kenë ndikuar në shpërndarjen e mandateve.

m) Sipas nenit 160, pika 4 të K.Z parashikohet se "Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të percaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KOZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse". Nga kjo dispozite kuptojmë se shklejet përveçse, duhet të kenë ndodhur në ambientet e qendrës së votimit, duhet që të jetë mbajtur edhe një raport nga K.Z.A.Z ose informationi t'i jete referuar KZAZ me shkrim nga qendra e votimit.

n) Për sa kohë, në asnjë moment nuk provohet sipas ligjit pavlefshmëria e zgjedhjeve në qëndrën e votimit, edhe kërkimi tjetër për përsëritjen e tyre sipas nenit 161 të Kodit Zgjedhor mbetet i pa bazuar në ligj dhe në prova.

## *III. Arsyetimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor:*

18. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoi pretendimet e palëve, çmon se Palët paditëse, subjektet zgjedhorë "Partia Demokratike e Shqipërisë" dhe "Partia Lëvizja Socialiste për Integrim" kanë parashtruar argumentet e tyre lidhur me kërkesën për pavlefshmërinë e zgjedheve të zhvilluara në datë 25.04.2021 në Republikën e Shqipërisë, për qarkun Vlorë.
19. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se synimi i ligjvënësit në miratimin e rregullave të posaçme për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikqyrjen dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve, të përmbledhura në Kodin Zgjedhor, ka qenë pikërisht respektimi dhe evidentimi i vullnetit të zgjedhësve, në garantimin e demokracisë në vend. Përmes vendosjes

së rregullave të qarta dhe të paracaktuara, synohet që të garantohet votimi i lirë, i fshehtë, i barabartë, i drejtëpërdrejtë/neni 3/2 i Kodit Zgjedhor. Zgjedhjet janë një element thelbësor i demokracisë në një vend të caktuar dhe zhvillimi i zgjedhjeve të lira, forcon vijueshmërinë e punës nga institucionet demokratike dhe mbizotëron sundimi i ligjit. Nga ana tjetër, veprimet manipuluese të zgjedhjeve apo kryerja ose jo e veprimeve që passjellin një administrim të dobët të procesit zgjedhor, ka një ndikim afatgjatë tek liritë kryesore të njeriut. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, e gjithë kjo periudhë (dhe jo vetëm) duhet të karakterizohet nga vendosmëria dhe transparenca, për të garantuar të drejtat demokratike në një vend të caktuar.

20. Në kuadër të garantimit të së drejtës së votës, ligjvënësi në Kodin Zgjedhor, ka përcaktuar saktësisht rastet e shpalljes së pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Konkretisht, neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton: *“KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhorë, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:*

    a) *Kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësi e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;*
    b) *Kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhesve në votim; ose*
    c) *Votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë”.*

21. Në vijim, në këtë dispozitë, neni 160 i Kodit Zgjedhor, ligjvënësi ka përcaktuar se e drejta për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi, u përket subjekteve zgjedhorë. Paragrafi i tretë i nenit 160 të Kodit Zgjedhor, përcakton taksativisht se subjekti zgjedhorë që paraqet kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve, duhet të paraqesë kërkesën e cila duhet të përmbajë shkaqet ligjore për përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.
22. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, në interpretim të neni 160 të Kodit Zgjedhor, argumenton se pavlefshmëria e zgjedhjeve përfaqëson rastin kur shkelja e ligjit, ka qenë e atillë, që ka cënuar rëndë procesin zgjedhor apo kur shkeljet e ligjit mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në atë masë, që ka ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore përkatëse. Është e kuptueshme që nëçdo rast kur pretendohet për ekzistencën e shkeljes së ligjit, që ka ndikuar dhe cënuar rëndë procesin zgjedhor apo ka cënuar procesin zgjedhor në atë masë që ka sjellë ndikim në ndarjen e mandateve, interpretimi dhe vlerësimi i “shkeljes” duhet bërë nisur nga kritere objektive. Pikërisht, objektiviteti në vlerësimin e rëndësisë së shkeljes, është i rëndësishëm, pasi synimi kryesor është garantimi i votës së lirë.
23. Duke qenë se “pavlefshmëria e zgjedhjeve” konsiderohet si një rast përjashtimor, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se i duhet kushtuar rëndësi të posaçme:
    <u>*Në radhë të parë*</u>, evidentimit të veprimeve apo mosveprimeve, të cilat konsiderohen, nga subjekti zgjedhor i interesuar, si shkelje të ligjit;
    <u>*Në radhë të dytë*</u>, provueshmërisë së ekzistencës reale të këtyre shkeljeve të pretenduara.
    <u>*Në radhë të tretë*</u>, provueshmërisë së lidhjes shkakësore midis shkeljes së evidentuar dhe pasojës/cënimit të rëndë të procesit zgjedhor.
24. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konsideron se jo më kot ligjvënësi në neni 160 të Kodit Zgjedhor ka përcaktuar specifikisht se subjekti zgjedhorë që ka pretendime për pavlefshmëri të

zgjedhjeve, kërkesën përkatëse duhet ta shoqërojë me shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre. Është e kuptueshme, që subjektet zgjedhorë (përgjithësisht ata që nuk përfaqësojnë pozitën qeverisëse) mund të kenë vështirësi në provueshmërinë e të gjithë elementëve të shkeljeve që ata pretendojnë se kanë ndodhur dhe që kanë ndikuar në cënimin e procesit zgjedhor. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor mban parasysh edhe këtë situatë, por vlerëson se subjekti zgjedhor që paraqet kërkesën për pavlefshmëri domosdoshmërisht duhet të parashtrojë raste konkrete, të parashtrojë argumente ligjorë, të atilla që të krijojnë bindjen në një nivel të arsyeshëm, tek cilido që njihet me këto raste apo argumente, për bazueshmërinë ligjore të tyre.

25. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se nuk ka rëndësi nëse shkeljet janë një ose më shumë, e rëndësishme është të evidentohet dhe të provohet se "shkelja" apo "shkeljet" tëjenë të një niveli të atillë, që kanë vënë në rrezik dhe kanë cënuar procesin zgjedhor, që të zhvillohet sipas parimeve kushtetuese dhe atyre ligjore. Kolegji vlerëson se subjektet zgjedhorë të interesuar duhet që të përshkruajnë qartazi dhe në mënyrë koncize, shkeljen apo shkeljet ligjore, të cilat sipas tyre kanë ndikuar në procesin zgjedhor. Në vijim, Kolegji vlerëson se subjekti zgjedhor, në rastet kur këto shkelje, nuk janë të identifikueshme qartësisht dhe publikisht, duhet që të argumentojë lidhjen shkakësore të drejtëpërdrejtë midis shkeljes/shkeljeve dhe cënimit tërëndë tëprocesit zgjedhor. Pikërisht, evidentimi i shkeljes/shkeljeve konkrete, argumentimi i lidhjes shkakësore midis shkeljes/shkeljeve dhe cënimit të procesit zgjedhor, do të mund të krijonte bindjen mbi bazueshmërinë e kërkimit për pavlefshmëri të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore.

26. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se në nenin 160 të Kodit Zgjedhor rastet e parashikuara nga pikat b dhe c të paragrafit të parë, lidhen ekskluzivisht me procedurën e votimit. Konkretisht, mosfillimi i votimit apo pezullimi i tij për më shumë se pesë orë, është një rast që mund të evidentohet qartazi dhe Kodi Zgjedhor, në parashikimet e tij, nuk e ka lidhur ekzistencën e këtij rasti me ardhjen e ndonjë pasoje konkrete. Kodi Zgjedhor ka parashikuar që evidentimi i këtij rasti, passjell pavlefshmëri të zgjedhjeve. Në gërmën b të paragrafit të parë të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ligjvënësi ka parashikuar se një rast kur mund të shpallet pavlefshmëria e zgjedhjeve, është në rastet e fatkeqësisë natyrore të përmasave të atilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim. Për të vlerësuar drejt, se cilat situata mund të konsiderohen si "fatkeqësi natyrore", Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i referohet kuadrit ligjor përkatës. Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", në nenin 3 të tij përcakton:*"Fatkeqësi natyrore" janë fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin".* Në nenin 4 të ligjit përcaktohet se: *"1. Çdo person ka të drejtën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. 2. Në rastet e fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, mbrojtja dhe shpëtimi i jetës së njerëzve kanë prioritet mbi çdo aktivitet tjetër të mbrojtjes civile".* Jo më kot, Kolegji citoi këto parashikime ligjore, për të evidentuar qartazi dhe kuptuar drejtë gjendjet e "fatkeqësive natyrore". Është e kuptueshme që Kodi Zgjedhor në përcaktimet e tij, i referohet vetëm atyre gjendjeve të fatkeqësive natyrore të atyre përmasave, që pengojnë pjesëmarrjen e zgjedhësve në votime. Kolegji vlerëson se ky rast i referohet pikërisht atyre situatave, kur pjesëmarrja masive në votime është penguar, pikërisht për shkak të evidentimit të gjendjes së fatkeqësive natyrore.

27. Kolegji vlerëson se kriza e shëndetit publik e shkaktuar nga “COVID-19” në vitin 2020, ka shkaktuar dëme të mëdha për shkak të humbjes së jetës së njerëzve, si dhe dëmtimit të ekonomisë dhe sistemeve shëndetësore në të gjithë botën. Përgjatë vitit të shkuar dhe në vijim, u evidentua qartazi se jo vetëm vendet në zhvillim e sipër, por edhe vendet e zhvilluara dhe me demokraci të konsoliduar prej dekadash, u gjendën përballë shumë vështirësive, në situatën e krijuar nga Pandemia e “COVID 19”. Është e kuptueshme që synimi kryesor është mbrojtja e jetës së qytetarëve. Por nga ana tjetër, kjo periudhë e vështirë që kanë kaluar pothuajse të gjithë vendet për shkak të Pandemisë, ka evidentuar sfida të tjera, që janë thelbësore për të garantuar demokracinë. Kolegji vlerëson se institucionet shtetërore, publike, subjektet zgjedhorë, shoqëria civile, ndërkombëtarët, që të gjithë bashkërisht duhet të bashkëpunojnë për të garantuar mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese dhe më e rëndësishme, është e drejta e jetës dhe shëndetit.
28. Në vijim, Kolegji vlerëson se rasti i parashikuar nga neni 160/1/a i Kodit Zgjedhor i referohet të gjithë situatës, parazgjedhore ose gjatë zhvillimit të procesit të zgjedhjeve. Tërësia e shkeljeve që mund të cënojnë procesin zgjedhor janë të shumta dhe lista e tyre, logjikisht, nuk mund të jetë shteruese, por duhet vlerësuar, nisur nga kritere objektive.
29. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konsideron të evidentojë se vetë ligji zgjedhor ka përcaktuar një kategori shkeljesh, të cilat cënojnë procesin zgjedhor dhe që përbëjnë kundravajtje administrative. Konkretisht, nëpjesën XIII të Kodit Zgjedhor “Përgjegjësitë dhe sanksionet” përcaktohen rastet konkrete të shkeljeve që mund të evidentohen dhe masat që merren.
30. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e gjen të drejtë arsyetimin e bërë nga KAS, sipas të cilit “*Shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që i pengojnë/largojnë zgjedhësit nëmasë nga votimi ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur*”. Kolegji vlerëson se shkeljet të cilat mund të passjellin shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, duhet të konsiderohen të asaj shkalle dhe rëndësie dhe vlerësohet se duhet t`i përgjigjen një pamundësie reale për të përcaktuar dëshirat dhe vullnetin e zgjedhësve. Kolegji vlerëson se evidentimi dhe provueshmëria e një shkelje apo shkeljeve të caktuara, duhet të pasohet nga vërtetimi i faktit që nga shkelja e kryer, ishte shtrembëruar vullneti i zgjedhësve dhe rrjedhimisht ishte ndryshuar rezultati i zgjedhjeve. Kolegji vlerëson se e rëndësishme është ruajtja e ligjshmërisë së procesit zgjedhor dhe garantimi i votës së lirë. Shpallja e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një ose disa zona zgjedhore mund të bëhet për arsye mjaft të motivuara. Është e kuptueshme që disponimi mbi kërkesat për pavlefshmëri të zgjedhjeve, nuk ka synim të ndryshojë vullnetin e zgjedhësve. Në këtë aspekt, Kolegji vlerëson se mbi baza objektive do të mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara se janë kryer dhe që kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, sipas pretendimeve të paraqitura në gjykim nga palët paditëse. Liria e vlerësimit të provave do të thotë që gjykata (Kolegji) do të përdorë në mënyrë të arsyeshme logjikën dhe gjykimin e drejtë. Është e kuptueshme që qëndrimi lidhur me të provuarit e fakteve, formohet në mënyrë graduale, me vlerësimin e çdo prove të paraqitur dhe administruar në gjykim.
31. Një aspekt tjetër i rëndësishëm që Kolegji vlerëson të theksojëështë provueshmëria e pretendimeve të ngritura, mbi ekzistencën e shkeljeve cënuese të procesit zgjedhor. Vetë Kodi i Procedurës Civile përcakton qartazi në nenin 11 të tij, kuptimin e provës: “*Provat janë të dhëna që merren në formën e parashikuar nga ky Kod dhe që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet apo prapësimet e palëve në proces”.* Fuqia provuese (nervus probationis) është aftësia e një prove për të krijuar bindjen për vërtetësinë ose jo të faktit. Barra e provës (onus probandi) është detyrimi i palës në proces e cila duhet të provojë faktin e pretenduar me

mjetet provuese. Secila palë ka detyrim ligjor të sigurojë të dhënat lidhur me faktet e pretenduara dhe propozimin për të siguruar provat. Vetë Kodi Zgjedhor e ka rregulluar këtë situatë lidhur me "barrën e provës" në nenin 136 të tij. Konkretisht, ligji zgjedhor i referohet llojeve të provave të parashikuara në K.Pr.Civile dhe detyrimin e palëve për të treguar ndër të tjera, faktet dhe provat ku mbështesin pretendimet e tyre.

32. Duke marrë parasysh procedurën që zhvillohet në këto raste dhe pozitën në të cilën gjenden subjektet zgjedhore përkundër pozitës së shumicës qeverisëse, ligjvënësi ka parashikuar se subjektet zgjedhorë kanë të drejtë të kërkojnë marrjen e provave, por sa më lart mund të realizohet nëse provohet që nuk është bërë e mundur sigurimi i këtyre provave nga vetë subjekti pretendues, duke treguar edhe shkaqet përkatëse. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e gjen me vend të arsyetojë se pretendimi për pavlefshmëri të zgjedhjeve, duke parashtruar shkeljet, duhet shoqëruar edhe me paraqitjen e provave që provojnë ekzistencën e këtyre shkeljeve. Ligji zgjedhor parashikon se vetë KQZ-ja mund të angazhohet në marrjen e këtyre provave, kur subjekti ankimues nuk ka mundur t`i sigurojë vetë provat. Në këtë situatë të fundit, nuk mjafton thjesht paraqitja e një kërkese formale, me përmbajtje të pretendimit për pamundësi të marrjes së provës, por kërkesa duhet të evidentojë edhe përpjekjet që ka bërë vetë subjekti për marrjen e provës dhe shkaku që ka penguar ose vonuar marrjen e provës. Kuadri ligjor është i mjaftueshëm, për të mundësuar sigurimin e informacioneve apo të dhënave nga subjektet zgjedhorë, në kuadër të sigurimit të "provave" që sipas tyre provojnë ekzistencën e shkeljeve që kanë ndikuar dhe cënuar procesin zgjedhor. Kodi i Procedurave Administrative, parashikon detyrimin e (onus probandi)/barrës së provës, palës iniciuese të procedurës administrative. Pavarësisht sa citohet më lart, Kolegji vlerëson se patjetër edhe vetë organi administrative merr masa për të siguruar provat e kërkuara nga palët e procedurës administrative. Por, Kolegji vlerëson se kjo gjë mund të realizohet atëherë kur pala në mënyrë bindëse dhe pa ekuivoke, provon faktin se kjo provë ekziston dhe ajo është gjendur në pamundësi për të siguruar marrjen e saj dhe për këtë arsye i drejtohet organit administrativ, për marrjen e provës. Kolegji vlerëson të theksojë faktin se pretendimet lidhur me ekzistencën e provave që provojnë shkeljet e kryera, nuk duhet të jenë formale, në kuadër të retorikës politike. Kolegji vlerëson se në interpretim të ligjit zgjedhor, pala/subjekti ankimues ka detyrimin të paraqesë provat; nëse nuk ka mundur t`i sigurojë vetë, duhet të paraqesë të dhëna të mjaftueshme dhe bindëse për ekzistencën e provës pranë një institucioni të caktuar shtetëror/publik. Kolegji vlerëson se nuk është e mjaftueshme thjesht parashtrimi i pretendimeve për cënim të procesit zgjedhor, por për të vlerësuar këtë gjë, duhet të paraqiten akte provuese. Përjashtimi që parashikon kuadri ligjor është për faktet e njohura zyrtarisht apo botërisht, të cilat nuk kanë nevojë të provohen.

33. Në gjykim, pala paditëse subjekti zgjedhor "Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim" paraqiti kërkesën për marrje të provave pranë institucioneve të ndryshme, nga ana e Kolegjit, kërkesë që e kishte paraqitur edhe pranë KAS dhe që nuk i ishte pranuar me argumentin se subjekti ankues nuk ka bërë përpjekje për të siguruar paraprakisht provat, sikurse kërkon neni 136/1/c i Kodit Zgjedhor, si dhe informacionet e kërkuara nuk gëzojnë cilësinë e provës, sipas K.Pr.Civile dhe për këtë shkak nuk mund të kërkohen si të tilla.

34. Kërkesën për marrjen e informacioneve pranë institucioneve të ndryshme, të cilat sipas palës paditëse subjekti zgjedhor "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", i konsideron prova në mbështetje të pretendimit të saj, Kolegji e rrëzoi në seancë gjyqësore, pasi u vlerësua se këto informacione të kërkuara për t`u marrë nuk ishin mjaftueshmërisht konkrete për nevoja të këtij gjykimi. Prova të tjera, palët paditëse nuk paraqitën në seancë, përpara Kolegjit.

35. Pas interpretimeve të sipërcituara, Kolegji vlerëson që të marrë në shqyrtim dhe të analizojë të gjitha pretendimet e ngritura nga palët paditëse.
36. Lidhur me pretendimet për paraqitje të një numri të konsiderueshëm të kallëzimeve penale pranë SPAK apo Prokurorive të rretheve gjyqësore, për konsumim të veprave penale në procesin zgjedhor. Kolegji vlerëson se drejt ka arsyetuar KAS në lidhje me këtë pretendim. Kolegji konsideron se paraqitja e kallëzimeve penale, jo domosdoshmërisht nënkupton se realisht është kryer një vepër penale. Kushtetuta dhe aktet ligjore dhe nënligjore përcaktojnë saktësisht kompetencat për hetimin në rastet e paraqitjes së kallëzimeve penale. Prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e posaçme, sipas kompetencave respektive, kanë të drejtë dhe njëkohësisht detyrim kushtetues dhe ligjor që të hetojnë veprat penale dhe të ushtrojnë ndjekjen penale ndaj kujtdo që kryen vepër penale, duke përfshirë edhe veprat penale që kryhen para, gjatë apo pas procesit zgjedhor. Kuadri kushtetues dhe ligjor në R.Sh. përcakton saktësisht se ekzistenca e kryerjes së veprës penale dhe autorësia e saj konfirmohen plotësisht dhe në mënyrë definitive me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Në gjykimin administrativ pranë KAS apo edhe në seancë gjyqësore të zhvilluar nga Kolegji nuk u paraqit asnjë provë nga palët paditëse në këtë drejtim, kuptohet përsa i përket zonës zgjedhore/qarku Vlorë, rezultatet e zgjedhjeve të së cilës kundërshtohen nëpërmjet këtij gjykimi. Në kushtet e mungesës së provueshmërisë së këtij pretendimi, se kryerja e krimeve të pretenduara zgjedhore ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, Kolegji nuk mund të pranojë apriori pretendimin për ekzistencë të shkeljes/shkeljeve, të ngritura në nivelin e një vepre penale, thjesht sepse është paraqitur një kallëzim penal. Është e kuptueshme që nëçdo rast, edhe nëse do të paraqiteshin vendime gjyqësore të formës së prerë ku të evidentohej kryerja e veprave penale gjatë procesit zgjedhor, Kolegji do të vlerësonte nëse kundërligjshmëria e veprimeve (të konsideruara si vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë) kishte cënuar në atë masë procesin zgjedhor, që mund të legjitimonte kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse. Në këtë logjikë të arsyetuari, Kolegji vlerëson se drejt ka argumentuar KAS dhe rrjedhimisht pretendimi i palëve paditëse si më lart cituar, do të konsiderohet si i pabazuar.
37. Një aspekt i rëndësishëm i garantimit të zgjedhjeve të lira dhe demokratike, është edhe procesi i financimit të zgjedhjeve dhe fushatës zgjedhore. Jo më kot, në ligjin zgjedhor është parashikuar më vete, në pjesa VII, të gjitha rregullat, ndalimet, pasojat në lidhje me sa më lart. Synimi i ligjvënësit në përcaktimin e këtyre parashikimeve ligjore ka qenë që të ndalojë përdorimin e fondeve publike për fushatën zgjedhore si dhe të jenë të kontrollueshme edhe dhurimet, trajtimet preferenciale, huatë etj.që bëhen përgjatë fushatës zgjedhore.
38. Në vendin tonë, janë ngritur në nivel publik, shqetësime të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë elektorale, si dhe është pretenduar për mungesën e vullnetit politik nga palët politike dhe institucionet për të përmirësuar standartet në këtë aspekt. Kolegji vlerëson se mekanizmat ligjorëpër të evituar këtë fenomen, duhet të jenë funksionalë, që të sigurojnë ndarje të qartë të burimeve shtetërore me fushatat elektorale. Nga ana tjetër, për të mundësuar sa më lart, nuk mjaftojnë thjesht parashikimet kushtetuese apo ligjore, por duhet që institucionet ligjzbatuese të japin shembuj të qartë të ndëshkimit të autorëve në rastet e abuzimit me pushtetin gjatë zgjedhjeve.
39. Në rastin konkret, pala paditëse ka pretenduar se VKM nr.1076 datë 24.12.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.555 datë 11.08.2011 të KM "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake

pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura të ndryshuar", është miratuar brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuar punonjësish publikë. Po kështu është pretenduar edhe për akte të tjera nënligjore të miratuara përgjatë kësaj periudhe kohore. KAS ka arsyetuar se vendimi i sipërcituar si dhe vendimi nr.19 datë 25.02.2021 i Këshillit Bashkiak "Për disa ndryshime në VKB nr.109 datë 18.10.2018 "Për miratimin dhe zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga buxheti i Bashkisë Vlorë", vërtet janë nxjerrë gjatë periudhës së ndalimit sipas nenit 91/4 të Kodit Zgjedhor, por sipas KAS këto shkelje formojnë kundërvajtje administrative në kuptim të nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Ndërkohë që, për VKM nr.1044 datë 18.12.2020 dhe për Vendimin nr.1102 datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2021", sipas KAS nuk përbëjnë shkelje pasi për vendimin e paréështë argumentuar se është miratuar përpara periudhës së ndalimit dhe për vendimin e dytë argumentohet se është një vendim procedurash dhe kriteresh lidhur me një fond qëështë dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021.

40. Lidhur me sa më lart, Kolegji vlerëson se në nenin 91 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se: "*Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullissë të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve etj. përvecse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të faktkeqësisë natyrore".* Kolegji gjen me vend arsyetimin e përdorur nga KAS në lidhje me dy aktet përkatëse VKM nr.1044 datë 18.12.2020 dhe Vendimin nr.1102 datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2021". Dukshëm vendimi nr.1044/2020 është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit të parashikuar në nenin 91/4 të Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër, edhe Kolegji vlerëson se vendimi nr.1102/2020 nuk mund të kategorizohet tek aktet që citon dispozita e sipërcituar, neni 91/4 i Kodit Zgjedhor. Përsa i përket VKM nr. 1076 datë 24.12.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.555 datë 11.08.2011 të KM "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura të ndryshuar", si dhe vendimit nr.19 datë 25.02.2021 i Këshillit Bashkiak "Për disa ndryshime në VKB nr.109 datë 18.10.2018 "Për miratimin dhe zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga buxheti i Bashkisë Vlorë", vendimet janë nxjerrë brenda afatit katër mujor që përcakton neni 91/4 i Kodit Zgjedhor, nga dita e zgjedhjeve, por Kolegji vlerëson se nxjerrja e këtyre akteve ka krijuar kushtet e formësimit të kundërvajtjeve administrative, në kuptim të nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër, KAS argumenton se nga verifikimet e kryera, subjekti zgjedhor përkatës nuk ka bërë ankim në KQZ për këtë shkelje, në kuadër të konsiderimit të saj si "kundërvajtje administrative". Kolegji vlerëson se vetë ligji zgjedhor ka parashikuar rregullat për të garantuar një fushatë zgjedhore, që të passjellë zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Për subjektet që kryejnë shkelje, ligji zgjedhor ka parashikuar edhe pasojat/ ndëshkimin, duke i konsideruar

shkelje të caktuara si kundërvajtje administrative. Kolegji vlerëson se pala paditëse nuk arriti të provonte se pikërisht miratimi i këtyre akteve të sipërcituara, nënligjore/administrative, kishte cënuar rëndë procesin zgjedhor, me pasojë ndryshimin e votës së zgjedhësve apo të kishte ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore përkatëse. Thjesht evidentimi i kryerjes sëkëtyre shkeljeve në miratimin e akteve të sipërcituara, në vlerësim të Kolegjit, nuk mund të passjellë disponimin mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse (qarku Vlorë). Ligjvënësi ka përcaktuar shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor (neni 160) dhe nisur nga aktet e miratuara të cituara më lart, Kolegji vlerëson se nuk mund të konsiderohen shkelje të atilla që kanë passjellë cënim të rëndë të procesit zgjedhor. Në këtë aspekt, ky pretendim i palës paditëse do të konsiderohet i pabazuar. Kolegji konsideron të drejtë edhe arsyetimin e bërë nga KAS lidhur me pretendimet për shpalljen e tenderit datë 06.01.2021 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

41. Përsa i përket pretendimit lidhur me pamundësinë e votimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Ligji zgjedhor ka parashikuar mundësinë që edhe shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, t`u garantohet e drejta e votës. Në nenin 20/1/dh të Kodit Zgjedhor përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar aktet me karakter normativ lidhur me rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e votimit të tyre, administrimin dhe numërimin e votave etj. Nga vendimi i KAS konstatohet se për zgjedhjet e përgjithshme të datës 25.04.2021, kjo gjë nuk është realizuar nga ana e Komisionit Rregullator dhe rrjedhimisht nuk është mundësuar votimi i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Pala paditëse parashtron se sa më lart, konsiderohet shkelje, që ka cënuar rëndë procesin zgjedhor. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se jemi në kushtet kur pamundësia e realizimit të votimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit (në vendet ku jetojnë) nuk do të mund të konsiderohet shkelje e atillë që passjell pavlefshmëri të zgjedhjeve nëqarkun e pretenduar, në qarkun Vlorë. Nuk argumentohet dhe nuk provohet nga pala paditëse lidhja shkakësore midis një situate të mosrealizimit të procesit të votimit, për shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit, me cënimin e pretenduar të procesit zgjedhor në qarkun Vlorë, konkretisht. Pikërisht, mosmarrja e masave për të mundësuar ushtrimin e së drejtës së votës nga shtetasit shqiptarë jashtë vendit, në vendet që jetojnë, nuk mund të passjellë apriori në rastin konkret, shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse (konkretisht qarku Vlorë), duke mos marrë parasysh në këtë mënyrë, predispozitën dhe gaditshmërinë e pjesëmarrjes në zgjedhje të shtetasve shqiptarë që kanë vlerësuar të ushtrojnë të drejtën e votës.

42. Lidhur me Urdhrin nr.219 datë 19.04.2021 “Për karantimin e personave që vijnë në R.Sh. nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”, urdhër i nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kolegji konstaton se referuar vendimit të KAS, urdhri është kundërshtuar gjyqësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI, por nuk është disponuar për shfuqizimin apo ndryshimin e tij. Sa më lart, nënkupton se urdhri ka qenë në fuqi dhe është nxjerrë, referuar edhe synimit të parashtruar në urdhër, për të parandaluar përhapjen e virusit SARS COV 2, në kuadër të masave që janë marrë përgjatë periudhës së pandemisë “COVID 19”. Në kushtet kur urdhri është nxjerrë dhe i referohet edhe periudhës së festave fetare (Pashkët), periudhë gjatë së cilës normalisht kontaktet midis njerëzve janë më të shumta dhe rrjedhimisht pasohet me shtim të udhëtimeve ndërshtetase, si dhe nisur nga fakti që urdhri ka pasur të përcaktuar edhe kohëzgjatjen e tij, Kolegji vlerëson se pala paditëse

nuk arriti të argumentonte bindshëm dhe as të provonte faktin se nxjerrja e këtij urdhri krijonte situatën e përshkruar në nenin 160 të Kodit Zgjedhor për shpallje të pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qarkun Vlorë. Nuk u argumentua mjaftueshëm, që të krijohej bindja tek Kolegji Zgjedhor Gjyqësor mbi faktin se nxjerrja e këtij urdhri kishte patur impakt të atillë në procesin zgjedhor në qarkun Vlorë, sa të mund të disponohet mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Po kështu, nuk u arrit të provohej cënimi i rëndë i pretenduar i procesit zgjedhor në zonën zgjedhore përkatëse (qarku Vlorë), specifikisht nga nxjerrja e këtij urdhri. Në këto kushte, edhe ky pretendim nuk qëndron.

43. Palët paditëse ka pretenduar se në qarkun Vlorë në ditën e zgjedhjeve kanë qenë 304 të infektuar me “COVID 19”, dhe kjo gjë ka passjellë pamundësinë e ushtrimit të së drejtës së votës nga ana e tyre, duke u konsideruar si një mohim de facto i së drejtës për të votuar. Në fakt, Kolegji vlerëson t`i përmbahet përcaktimeve në Kodin Zgjedhor, i cili nuk parashikon mundësinë e votimit në distancë për zgjedhësit që ndodhen në territorin shqiptar. Në kushtet, kur kuadri ligjor nuk e parashikon si mundësi dhe kjo gjë nuk është atakuar në rrugë ligjore, ashtu sikurse edhe rregullat e vendosura për izolimin përsa i përket marrjes së masave për mospërhapjen e virusit SARS COV 2, nuk rezulton të jenë ndryshuar, si rezultat i kundërshtimit gjyqësisht të tyre, Kolegji vlerëson se nisur nga situata pandemike, duke marrë parasysh synimin për mbrojtjen e të drejtës së jetës dhe shëndetit, sa më lart nuk konsiderohet shkelje e atillë që cënon rëndë procesin zgjedhor, sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, Kolegji konsideron se situata pandemike është shtrirë në një periudhë, tashmë më shumë se një vjeçare dhe që në momentin që subjektet zgjedhorë janë dakordësuar për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme, në një situatë pandemie, si dhe përsa kohë që masat e marra janë në proporcion me situatën e krijuar, pretendimi i ngritur nga pala paditëse, për arsyet e lartëpërmendura, nuk qëndron dhe do të konsiderohet i pabazuar.

44. Kolegji vlerëson të theksojë faktin se strategjitë e fushatave zgjedhore janë një formë specifike e strategjive politike. Objektivi i tyre është pikërisht arritja e rezultateve të kënaqshme nga zgjedhjet që zhvillohen. Është e kuptueshme që subjektet zgjedhorë janë në një garë elektorale/garë votash dhe për këtë arsye është e nevojshme që subjektet zgjedhorë të kenë strategji të mirëpërcaktuara, që përpara nisjes së fushatës zgjedhore. Është e kuptueshme qëçdo forcë politike përdor strategjitë e saj para apo gjatë fushatës zgjedhore. E rëndësishme është që çdo strategji e përdorur të mos përfshijë kryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, pasi përndryshe, pasojat përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi.

45. Lidhur me pretendimin e parashtruar nga pala paditëse për krijimin, nga ana e subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë,të një baze të dhënash personale (database) për një numër të konsiderueshëm zgjedhësish, në të cilën gjenin pasqyrim në mënyrë aluduese preferencat politike, i njohur ndryshe, referuar edhe nga jehona në media që pati ky lajm, “skandali i patronazhistëve”, Kolegji vlerëson se nuk u provua në gjykim ndikimi i publikimit mbi ekzistencën e kësaj baze të dhënash, tek personat që kanë ushtruar të drejtën e votes në qarkun Vlorë. Në vlerësim të Kolegjit, referuar gjithmonë objektit të gjykimit, konsiderohet se pala paditëse nuk arriti të provonte faktin se strategjia e pretenduar se është ndjekur lidhur me “patronazhistët”, të ketë pasur impakt mbi vullnetin e zgjedhësve për pjesëmarrje në votime apo për preferencat e tyre përkundrejt partive politike. Aq më pak, në gjykim nuk u provua ndikimi i pretenduar i krijimit të kësaj baze të dhënash, mbi zgjedhësit e qarkut Vlorë. Është e kuptueshme që mbrojtja e të dhënave personale formon lëndën e trajtuar në ligjin përkatës nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në ligj bëhen

parashikimet përkatëse edhe për mekanizmat apo rrugët ligjore që ndiqen për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale. Në vijim, referuar natyrës së këtij gjykimi, Kolegji nuk e gjen me vend të argumentojë më shumë lidhur me këtë pretendim të paraqitur në gjykim, pasi në kompetencë të Kolegjit është vlerësimi nëse "fenomeni" i pretenduar si më lart, i konsideruar si shkelje nga pala paditëse, ka ndikuar ose jo në një masë të rëndë në cënimin e procesit zgjedhor. Kolegji i qëndron argumentimit se sa më lart nuk provohet të ketë sjellë impakt në vullnetin e zgjedhësve për pjesëmarrje në votime apo lidhur me preferencat e tyre partiake.

46. Pala paditëse ka parashtruar edhe një sërë pretendimesh të cilat lidhen me fenomenin e "shitblerjes së votës", "përfshirjes në fushatën zgjedhorë të personave me rekorde kriminale". Lidhur me sa më lart, Kolegji konstaton se këto pretendime janë të karakterit të përgjithshëm dhe nuk referojnë në raste konkrete të pretenduara se kanë ndodhur në qarkun Vlorë, të atilla që mund të kenë ndikuar në shtrembërimin e votës popullore dhe rrjedhimisht në cënimin me baza të gjera dhe të rënda, të procesit zgjedhor në qarkun Vlorë. Kolegji vlerëson se nuk u arrit, nga pala paditëse, që të argumentohej lidhja shkakësore midis "përfshirjes në fushatë zgjedhore të personave me rekorde kriminale", edhe sikur të provohej kjo gjë, me pasojën e ardhur/rezultatin e zgjedhjeve. Kolegji vlerëson se pala paditëse nuk argumenton mjaftueshëm mbi lidhjen e pretenduar midis angazhimit në fushatë të personave që mund të jenë të dënuar (edhe sikur ky fakt të jetë i vërtetë) me cënimin e procesit zgjedhor. Kolegji vlerëson se disponimi mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve duhet të bazohet në prova që qartësisht evidentojnë cënimin e rëndë të procesit zgjedhor nga veprimet e kryera në shkelje të ligjit dhe në këtë logjikë, Kolegji nuk mund të bazohet thjesht në hamendësime të përgjithshme dhe të pafaktuara.
47. Përsa i përket pretendimit mbi përdorimin e burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore, në dhënien e lejeve të legalizimit/procedura që sipas palës paditëse janë kryer në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin e Komisionit Rregullator, me rritjen e rasteve të punësimit, thjesht e vetëm për qëllime elektorale, të dhënies së ndihmave, dhënie ose premtime për dhënie përfitimeve nga skemat shtetërore etj. Kolegji vlerëson se pala paditëse duhej të faktonte lidhjen midis këtyre veprimtarive me pasojën që pretendohet se ka ardhur/cënim të rëndë të procesit zgjedhor në qarkun Vlorë.Në vendimin përkatës, KAS ka parashtruar se të paktën në një rast, ka rezultuar e provuar se subjekti Partia Socialiste ka zhvilluar veprimtari të fushatës zgjedhore në ambiente të institucioneve publike, veprimtari e ndaluar nga Kodi Zgjedhor/neni 78/6, duke u konsideruar si kundërvajtje administrative. Kolegji vlerëson se pavarësisht sa më lart, pala paditëse nuk arriti që të argumentonte bindshëm, se cili rast konkret, i përdorimit të burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore, se rritja e punësimeve, dhënia e lejeve të legalizimit, kryerja e punëve apo investimeve publike gjatë fushatës zgjedhore etj. kishin pasur impakt <u>në radhë të parë</u> në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votime dhe <u>në radhë të dytë</u> në preferencat partiake të zgjedhësve. Pikërisht, mungesa e faktimit të rasteve konkrete të pretenduara nga pala paditëse, mungesa e provueshmërisë së lidhjes shkakësore midis veprimtarive të ndaluara dhe pasojës së pretenduar se ka ardhur, krijon bindjen tek Kolegji se edhe këto pretendime nuk u provuan në gjykim. Përsa kohë që nuk arrihet të provohet impakti negativ dhe cënues i procesit zgjedhor nga këto veprimtari të ndaluara, në kushtet edhe kur këto "fenomene" të pretenduara se kanë ndodhur, citohen në mënyrë të përgjithshme dhe nuk faktojnëndikimin mbi procesin zgjedhor, në atë nivel, që mund të passjellin pavlefshmëri të zgjedhjeve, atëherëështë logjike që konkluzioni në të cilën arrin Kolegji, është që këto pretendime nuk mund të konsiderohen si të bazuara.

48. Kolegji vlerëson të theksojë faktin se pala paditëse duhej që të argumentonte veprimtarinë ndaluese konkrete që pretendohet se është kryer dhe impaktin në procesin zgjedhor në një qendër votimi ose disa të tilla të caktuara dhe jo në mënyrë të përgjithshme të citojë veprimtaritë e ndaluara. Nuk mund që një veprimtari e caktuar, qoftë edhe sporadike, të passjellë pavlefshmëri të zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore përkatëse. Kolegji, në interpretim të Kodit Zgjedhor, konsideron se një veprimtari e ndaluar e kryer gjatë fushatës zgjedhore, nuk mund apriori të passjellë pavlefshmëri të zgjedhjeve. Situata e përshkruar në nenin 160 të Kodit Zgjedhor, kuptohet qëështë një situatë përjashtimore, e cila mund të ndodhë në raste të caktuara, të cilat janë karakterizuar nga shkelje të atilla, me evidentimin dhe provueshmërinë e të cilave, Kolegji krijon bindjen se kanë ndikuar rëndë në procesin zgjedhor dhe që rezultati i nxjerrë nuk i përgjigjet realisht vullnetit të zgjedhësve.
49. Lidhur me pretendimet mbi miratimin e ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr.115/2020, ndryshimeve në ligjin “Kodi Zgjedhor” me ligjin 118/2020, pa pëlqim të subjektit ankues, Kolegji e gjen me vend të theksojë faktin se legjislacioni shqiptar parashikon shumë qartë mënyrën e atakimit, në mënyrë gjyqësore të akteve normative përkatëse. Në këtë këndvështrim, Kolegji nuk konsideron të ndalet me argumente të tjera shtesë lidhur me këtë pretendim, përsa kohë që ndryshimet kushtetuese dhe ligjore janë në fuqi dhe zbatohen.
50. Kolegji konsideron të ndalet edhe në argumentat e përdorura nga pala paditëse, sipas së cilës pretendimet e saj provohen edhe nga “gjetjet” apo “deklaratat publike” të bëra nga ndërkombëtarët/misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR. Në vendimin përkatës, KAS ka bërë edhe parashtrimet përkatëse lidhur me deklaratën e misionit vëzhgues OSBE/ODIHR lidhur me zgjedhjet e zhvilluara, e cila, sipas KAS, nuk përmban të dhëna specifike për qarkun Vlorë, dhe se gjetjet dhe konkluzionet paraprake janë të besueshme dhe të pranueshme. Kolegji vlerëson se në kuadër të bashkëpunimit me ndërkombëtarët, misionet vëzhguese, ndër të tjera, me konstatimet e tyre, ndihmojnë nëevidentimin e problematikave që janë shfaqur gjatë një procesi zgjedhor si dhe ndërmarrjen e inisiativave, në tëardhmen, për ndryshime ligjore apo në krijimin e mekanizmave të përshtatshëm, për të arritur qëllimin final, qëështë zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Në këtë aspekt, Kolegji vlerëson se drejt ka argumentuar KAS lidhur me këtë pretendim të sipërcituar të palës paditëse.
51. Përsa i përket pretendimeve për pavlefshmëri të zgjedhjeve, duke bërë lidhjen midis konstatimit, në këto zgjedhje, të një përqindje, të konsideruar të lartë nga pala paditëse, të votave të pavlefshme, pasojë, ndër të tjera, sipas palës paditëse edhe të mënyrës së kompozimit të fletës së votimit, me numra dhe jo me emra, Kolegji vlerëson se ky i fundit me vendimin nr.5 datë 04.04.2021, është shprehur lidhur me pretendimet e subjekteve zgjedhorë mbi kompozimin e fletës së votimit (vendimi është i formës së prerë), ndërkohë që, Kolegji vlerëson se nuk u argumentua nga pala paditëse lidhja midis evidentimit dhe konstatimit të votave të pavlefshme me cënimin e procesit zgjedhor. Pavlefshmëria e votave (duke marrë parasysh edhe faktin se vota është e fshehtë) nënkupton edhe pamundësinë e evidentimit të vullnetit real të zgjedhësit/zgjedhësve dhe për pasojë edhe pamundësinë e verifikimit të cënimit real të secilit subjekt zgjedhor. Duke konkluduar, Kolegji vlerëson se pala paditëse nuk arriti të argumentonte lidhjen midis evidentimit të një përqindje të caktuar tëvotave të pavlefshme dhe cënimit të rëndë të procesit zgjedhor. Pavlefshmëria e votave mund të vijë si rezultat i faktorëve të ndryshëm.
52. Përsa i përket pretendimit për kryerjen e votimeve të shumëfishta, pas kontrollit të kryqëzuar të të dhënave PEI, duke pretenduar se ka patur parregullsi në administrimin e

pajisjeve të përdorura për identifikimin e zgjedhësve, të cilat kanë lidhje me regjistrimin e një gjurme daktiloskopike për më shumë se një identitet zgjedhësi, sikurse ka pasur raste të personave me identitet me gjurmë daktiloskopike të njëjta në dy qendra votimi të ndryshme/pretendim i palëve paditëse, KAS në vendimmarrjen e tij parashtron se është marrë edhe dëshmia e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve. Sipas KAS, pas shqyrtimit të materialit të servirur nga KQZ, rezultatet e përftuara formojnë indicie për hetimin administrativ të KQZ-së, por nuk formojnë dot prova për të mbështetur pretendimin e subjekteve ankuese për raste të shumta të votimit të dyfishtë. Konkretisht, sipas KAS, për zonën zgjedhore përkatëse, ka një listë prej 23 raste të identifikuara me gjurmë daktiloskopike të dyshuara të njëjta nga pajisjet, por jo të përputhshme. Vetëm nëdy raste ky dyshim përqas gjurmën daktiloskopike me identitetin e njëjtë në dy qendra votimi të ndryshme. Kolegji, pasi u njoh me pretendimet e palëve paditëse dhe argumentat e përdorura nga KAS, i gjen këto të fundit (argumentat e përdorura nga KAS) si të mbështetura. Konkretisht, nga vetë KAS pranohet se nga rezultatet e marra krijohen indicie për kryerje të verifikimeve të tjera, por realisht nuk është evidentuar dhe as palët paditëse nuk provuan ekzistencën në masë të fenomenit të "votimit të shumëfishtë". Për më tepër, nuk u arrit të faktohej konkretisht, se cilat ishin këto raste konkrete të votimit të pretenduar të shumëfishtë, që kishin pasur impakt të atillë në procesin zgjedhor, sa passillnin pavlefshmëri të zgjedhjeve. Rrjedhimisht, edhe ky pretendim vlerësohet si i pabazuar.

53. Në sintezë të arsyetimit të sipërcituar, Kolegji konstaton se lidhur me shkeljet e pretenduara se janë kryer, një pjesë e tyre (siç është cituar më lart) nuk u provua ekzistenca e tyre; për pjesën tjetër, u konstatua se edhe në rast të konsiderimit të tyre si shkelje, nuk kanë passjellë impaktin në cënimin e rëndë të procesit zgjedhor.
54. Në konkluzion, Kolegji vlerëson se kërkesëpadia e paraqitur nga subjekti "Partia Lëvizja Socialiste për Integrim" dhe kërkesëpadia e paraqitur nga subjekti "Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim", janë të pambështetura në prova dhe në ligj dhe rrjedhimisht duhen rrëzuar. Kolegji rithekson edhe një herë se të gjitha pretendimet e ngritura nga palët paditëse, nëpërmjet këtij gjykimi, nuk arritën të krijonin bindjen tek Kolegji, mbi bazueshmërinë e tyre ligjore dhe faktike. Kolegji konsideron se shkeljet e pretenduara se janë kryer, qoftë në kuadër të nxjerrjes së akteve normatike apo administrative, qoftë në kuadër të kryerjes së veprimeve të kundërligjshme, nuk plotësojnë kushtet e krijimit të situatës përjashtimore që përcakton neni 160 i Kodit Zgjedhor për pavlefshmërinë e zgjedhjeve të datës 25.04.2021, në qarkun Vlorë. Shkeljet e pretenduara nuk u provua se kanë pasur impakt të atillë mbi procesin zgjedhor, në drejtim të pjesëmarrjes së zgjedhësve në votime, në drejtim të ndikimit mbi vullnetin e tyre në ushtrimin e së drejtës së votës, dhe as në drejtim të tjerërsimit të votës popullore.
55. Si përfundim, shkeljet e pretenduara, qoftë edhe ato të evidentuara nga KAS dhe në vijim nga Kolegji, nuk janë të një niveli të tillë, që të passjellin cënimin e rëndë të procesit zgjedhor apo të kenë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore, qarku Vlorë. Si rrjedhim, këto shkelje të pretenduara nuk mund të shërbejnë si arsye e ligjshme për të shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qarkun Vlorë.
56. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se drejt ka arsyetuar KAS në marrjen e vendimit nr.87 datë 20.05.2021. Rrjedhimisht, nuk ka vend për shfuqizimin apo ndryshimin e këtij vendimi të marrë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

57. Kolegji konsideron dhe disponon mbi rrëzimin e kërkesëpadive të palëve paditëse “Partia Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim” si të pabazuara në prova dhe në ligj.

**PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

**V E N D O S I**

- Rrëzimin e padive të palëve paditëse “Partia Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim” si të pabazuara në prova dhe në ligj.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë, sot më datë 01.06.2021.

| | | |
|---|---|---|
| **GJYQTAR**<br>**Asim VOKSHI** | **GJYQTARE**<br>**Alma KOLGJOKA** | **GJYQTARE**<br>**Esmeralda XHILI** |

| | |
|---|---|
| **GJYQTARE**<br>**Emona MUÇI** | **GJYQTARE**<br>**Manjola XHAXHO** |